

Rimëkëmbja ekonomike dhe ndërtimi i bashkëpunimit ndër-institucional

Analizë e Politikave

3/2021



Rimëkëmbja ekonomike dhe ndërtimi i bashkëpunimit ndër-institucional

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Qeverisje Demokratike**

Publikimi: **Mars, 2020**

Foto e ballinës: **Pexels**



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



KFOS
Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

Ky publikim është mbështetur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Pandemia Covid-19 dhe përgjigja ndaj krizës globale	3
Metodologjia.....	5
Rimëkëmbja, statusi i implementimit dhe sfidat.....	6
Pakoja Emergjente Fiskale	6
Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike.....	8
Aktivitetet minerare dhe zbatimi i Ligjit të Rimëkëmbjes.....	9
Subvencionimi i BRE-ve dhe Ligji i Rimëkëmbjes Ekonomike.....	9
Sektori financiar dhe Pakoja e Rimëkëmbjes	10
Zbatimi i dizpozitave të Trusti	11
Përfundime.....	13
Rekomandime	14

Pandemia Covid-19 dhe përgjigja ndaj krizës globale

Që nga dhjetori 2019 kur edhe zyrtarisht u shfaqën rastet e para të infektuara me COVID-19, filluan të shfaqen edhe shenjat e para të ndikimit negativ të këtij virusi në sektorët e ekonomisë dhe shëndetësisë nëpër botë. Kjo pasiqë të gjitha vendet filluan të alarmohen nga rreziqet që mund të i bartë përhapja globale e këtij virusi. Si problem kryesor ishte edhe mos-njohja e natyrës së këtij agjenti, përfshirë këtu edhe mungësën e informacioneve se si dhe në çfarë suaza do të duhej të sillemi karshi këtij vrasësi të padukshëm.

Problemet filluar të rriten, me shndërrimin e kësaj gjendje në një gjendje pandemike, e cila përfshiu gjithë botën. Në fillim, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) raportoi një grup rastesh me pneumoni në Wuhan, saktësisht në Provincën Hubei. Në vazhdimësi, në fillim të janarit u konfirmuan edhe rastet e para të paraqitjes së virusit jashtë territorit të Kinës, saktësisht në Tajlandë.

Rastet e para të paraqitjes së COVID-19 në kontinentin evropian ishin në shtetin e Francës. Më 21 shkurt 2020, u konfirmuan 47 raste të COVID-19 të cilat u raportuan në OBSH në Rajonin Evropian dhe ishin 4 rastet e para që ishin konfirmuar si vdekje nga ky patogjen. Tri rastet e para të zbuluara u raportuan në Francë në 24 Janar 2020 dhe kishin fillimin e simptomave përkatësisht në 17, 19 dhe 23 Janar. Më 21 shkurt, nëntë vende kishin raportuar raste (Figura 1): Belgjika(1), Finlanda (1), Franca (12), Gjermania (16), Italia (3), Rusia (2), Spanja (2), Suedia (1).




Figure 1. Lektorja epidemike e rasteve të raportuara COVID-19 sipas datës së shfaqjes së simptomave, ose datës së njoftimit, Rajoni Evropian i OBSH-së, në 21 Shkurt 2020 (n = 38) a, b¹

¹Eurosurveillance, (2020), Spiteri G. et al., First cases of coronavirus disease 2019 (COVID-19) in the WHO European Region, 24 January to 21 February 2020 separator, E qasshme në: <https://www.eurosurveillance.org/content/10.2807/1560-7917.ES.2020.25.9.2000178> (e qasur në nëntor, 2020)

Përfaqësuesit e OBSH-së të shqetësuar thellë nga rastet alarmante të përhapjes dhe ashpërsisë së simptomave të virusit, vlerësuan virusin COVID-19 si një pandemi. Shpallja e këtij virusi pandemi ndodhi më 11 mars të vitit 2020. Me shpalljen e tij si pandemi, shtetet anembanë botës filluan mobilizimin e tyre si kundërpërgjigje ndaj pandemisë. Virusit filloi të përhapej me një shpejtësi shumë të madhe dhe filloi edhe rritja e numrit të viktimave.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me shpalljen e masave parandaluese dhe mbylljeve totale nga shtetet evropiane dhe ato botërore, ka marrë 5 vendime shumë të rëndësishme për masat parandaluese në funksion të mbrojtjes nga COVID-19. Kështuqë, fillimisht në mbledhjen e datës 11 mars 2020, u aprovua vendimi nr.01/07, ku u vendosën 11 masat e para parandaluese të miratuara nga kabineti qeveritar. Ndër to, përfshihej ndërprerja e procesit edukativo-arsimor në të gjithë vendin, pezullimi i përkohshëm i linjave tokësore dhe ajrore, u vendos për vetëkarantinim të detyruar për të gjithë qytetarët që hyjnë në Republikën e Kosovës nga zonat epidemike me rrezik të lartë dhe të mesëm, masa këto që u vendosën në përputhje me udhëzimet e OBSH-së.²

Këto masa u ashpërsuan me paraqitjen e rasteve të para me COVID-19 në Kosovë. Rastet e para u paraqitën dy ditë pas mbylljes totale të vendit. Me paraqitjen e tyre, Qeveria e Republikës së Kosovës me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë aprovoi vendimin nr.01/11, i datës 15 mars 2020 ku u shpall gjendja e emergjencës në shëndetin publik. Gjithashu, këto masa përfshinin edhe ndalimin e aktiviteteve publike dhe jopublike, e deri në ndalimin e qarkullimit për qytetarët vetëm në rastet kur qarkullimi i tyre ishte shumë i nevojshëm. Këto masa ndihmuan në mbajtjen nën kontroll të gjendjes së vendit, duke ndikuar kështu edhe në kontrollimin më të lehtë të përhapjes së virusit në popullatë.

Sikurse në shumicën e vendeve të botës, edhe në vendin tonë masat e marra si kundërpërgjigje ndaj pandemisë COVID-19 kanë ndikuar dhe vazhdon ende të ndikojë negativisht në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Ky ndikim është vërejtur edhe në veprimtarinë e bizneseve dhe në zhvillimin e tërësishëm ekonomik në Kosovë. Krahas zhvillimit ekonomik, një goditje të rëndë e pësoi edhe sektori i shëndetësisë i cili që në fillim nuk kishte kapacitetet e mjaftueshme për ta përballuar këtë gjendje. Prandaj edhe paniku i popullatës sa i përket këtyre kapaciteteve vazhdonte të rritej.

Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës përgatiti Pakon Emergjente Fiskale si hap i parë drejt adresimit të problemeve ekonomike dhe sociale të rezultuara nga pandemia, duke përfshirë kështu veprime dhe intervenime që kanë për synim ndihmesën e menjëherëshme për qytetarët në ato role apo funksione që ata janë dëmtuar nga pandemia. Kjo pako u miratua më 30 mars 2020. Përmes kësaj pakoje, qytetarët e Republikës së Kosovës patën mundësi të përfitojnë në pika të ndryshme të cilat ishin adresuar me qëllim rikuperimin e gjendjes që kishte shkaktuar pandemia COVID-19.³

² Qeveria e Republikës së Kosovës, (2020), Vendimi Nr. 01/07. I qasshëm në: https://www.mit-ks.net/repository/docs/2020_03_12_122521_Vendimet_e_Mbledhjes_se_7-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2020.pdf (e qasur në janar 2021)

³ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2020), Vendimi Nr. 01/19, Pakoja Emergjente Fiskale, e qasshme në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf> . (E qasur në dhjetor 2020)

Tutje, muajt në vazhdim, Qeveria e Republikës së Kosovës paraqiti para Kuvendit projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike – COVID-19. Shqyrtimi i këtij Projektligji dhe shtimi i rekomandimeve të vazhdueshme nga Komisionet kryesore të Kuvendit ndikuan që periudha e miratimit të tij të zgjasë. Miratimi i Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike u arrit më 4 dhjetor 2020 dhe para publikut u paraqitën masat të cilat do i përmbajë Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike e cila rregullohej përmes këtij Ligji.

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e këtij punimi është e përzier, kuantitative dhe kualitative. Në pjesën e hulumtimit kuantitativ, INDEP përmes metodës së observimit dhe hulumtimit në tavolinë ka mbledhur të dhëna dhe informata mbi hapat e zbatimit të pakos së rimëkëmbjes, rezultatet kryesore të këtij zbatimi përfshirë numrin e njerëzve të përfshirë etj. Krahas kësaj, INDEP ka plotësuar gamën e informatave kuantitative edhe përmes hulumtimit kualitativ.

Punimi është realizuar në kornizën e procesit të monitorimit të pakos së rimëkëmbjes, pra është kulminim i pesë buletineve informuese të deritanishme. Për realizimin e këtyre buletineve, INDEP ka zhvilluar tre intervista të pastrukturuara me aktor institucional përfshirë Komisionin e pavarur për Miniera dhe Minerale, Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji. Këto takime kanë shërbyer për të thelluar informatat dhe dijen dhe përveç pyetjes “sa”, t’u përgjigjemi edhe pyetjeve “si” dhe “në ç’mënyrë”.

Pas mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave ka kaluar në dy faza kryesore. Në fazën e parë, në kemi sistemuar të dhënat dhe i kemi bërë një analizë të përmbajtjes. Në pjesën e dytë ne kemi tabuluar të dhënat nga hulumtimi kuantitativ me përfundimet e nxjerra nga intervistat për të nxjerrë qëndrimet përfundimtare. Në fund, hulumtimi ka kaluar edhe nëpër një analizë të përgjithshme të kontekstit zhvillimor të Kosovës ku edhe kemi përshtatur disa nga përfundimet me aktualitetin ekonomik dhe politik të vendit.

Rimëkëmbja, statusi i implementimit dhe sfidat

Dëmet që filluan të i shkaktohen ekonomisë së vendit menjëherë pas miratimit të masave të para parandaluese për përhapjen e virusit covid-19, ishin të mëdha. Duke parë pasojat që po i shkaktohen ekonomisë së vendit nga masat e ndërmarra me shfaqjen e pandemisë, Qeveria e Kosovës filloi të i adresojë problemet me të cilat filluan të ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Kjo situatë padyshim se ndikoi negativisht në zhvillimin ekonomik.

Pakoja Emergjente Fiskale

Fillimisht, më 30 mars 2020 Kryeministri i Republikës së Kosovës, mbajti mbledhjen në të cilën u aprovua Pakoja Emergjente Fiskale. Kjo pako kapi vlerën prej rreth 170 milion euro. Në total kjo pako ka përmbajtur 15 masa të cilat kanë përfshirë sektorët më të prekur nga pandemia.

Tabela 1. Masat e Pakos Emergjente Fiskale dhe shuma e kostos së tyre

Masat	Përshkrimi	Shuma(në euro)
1	Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit e skemave sociale për muajin Prill dhe Maj	7,650,000.00 €
2	Pagesa shtesë në vlerë prej tridhjetë (30 €) euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ultë se njëqind (100 €) euro, për muajin Prill, Maj dhe Qershor	13,000,000.00 €
3	Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare si pasojë e rënies së veprimtarisë së tyre për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik	
3.1	Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve në vlerë prej njëqind e shtatëdhjetë (170 €) euro, për muajin Prill dhe Maj	41,000,000.00 €
3.2	Subvencionimi i qirasë deri në pesëdhjetë (50%) të vlerës së qirasë për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për muajin Prill dhe Maj	12,000,000.00 €
3.3	Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat lidhur me masat e parapara me këtë vendim për muajin Prill dhe Maj	8,000,000.00 €
4	Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike që kanë vështirësi financiare për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, me qëllim të sigurimit të likuiditetit të përkohshëm të tyre, me kthim deri më 31.12.2020	20,000,000.00 €
5	Sigurimi i mbështetjes shtesë financiare për Komunitetet e Republikës së Kosovës që janë ndikuar në përballje me pandeminë, në rast nevojë për shkak të zgjatjes eventuale të situatës së emergjencës së shëndetit publik	10,000,000.00 €
6	Sigurimi i shtesës mbi pagë në vlerë prej treqind (300 €) euro për punëtorët në terren dhe që janë të ekspozuar drejtpërdrejt rrezikut të infektimit në punën e tyre	15,000,000.00 €
7	Pagesë shtesë në vlerë prej njëqind (100 €) euro për punëtorët e	3,000,000.00 €

	dyqaneve ushqimore, furrave dhe farmacive për majin Prill dhe Maj	
8	Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë (130 €) euro për qytetarët që humbin vendin e tyre të punës për shkak të situatës së emergjencës së shëndetit publik, për muajin Prill, Maj dhe Qershor	4,000,000.00 €
9	Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, që janë goditur më rëndë nga situata e emergjencës së shëndetit publik	2,000,000.00 €
10.1	Sigurimi i likuiditetit financiar për Mikro-ndërmarrjet dhe të vetë-punësuarit nëpërmjet programeve të caktuara të Fondit për Garantimin Kreditor të Kosovës, në shumën dhjetë mijë (10,000 €) euro për periudhën 24 muajsh	15,000,000.00 €
10.2	Sigurimi i likuiditetit financiar, Shoqëritë Tregtare/Kompanitë të autorizuar që ofrojnë shërbime bazike (të ngjashme me ato të ndërmarrjeve publike) me kthim deri më 31.12.2020, në kudër të vlerës së përcaktuar në 1.4. të këtij vendimi	
11	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për rritje të prodhimit bujqësor	5,000,000.00 €
12	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për evitimin e situatës së krijuar nga situata e emergjencës së shëndetit publik në aktivitetet sportive dhe kulturore	5,000,000.00 €
13	Mbështetje për eksportuesit në Republikën e Kosovës pas përfundimit të situatës së emergjencës së shëndetit publik	10,000,000.00 €
14	Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnëpunëtorët me kontratë pune së paku një (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës së shëndetit publik, nga njëqind e tridhjetë (130€) euro për dy muajt pasues pas regjistrimit	6,000,000.00 €
15	Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë (130 €) euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë tëhyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajin Prill, Maj dhe Qershor	3,000,000.00 € ⁴

Kjo pako e miratuar nga Qeveria, në kohë pandemie kishte për qëllim që të mbante ekonominë e vendit të padëmtuar në mënyrë ireversibile.

Pakoja Emergjente Fiskale, edhe pse u aprovua dhe filloi zbatimin në kohë, efekti i saj nuk ishte afatgjatë. Në ndërkohë, Qeveria e Kosovës propozoi edhe Projektligjin për Prandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës. Ky projektligj u shqyrtua nga Komisioni Funkcional dhe me rekomandimet e tyre u shqyrtua në Kuvendin e Kosovës. Në gusht të 2020, ky ligj u miratua dhe filloi zbatimi i tij.

⁴ Qeveria e Republikës së Kosovës, (2020), Vendimi Nr. 01/19, Pakoja Emergjente Fiskale, e qasshme në: <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/03/Vendimi-i-Qeveris%C3%AB-nga-Mbledhja-e-19.pdf> . (E qasur në janar 2021)

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike

Pas zbutjes graduale të masave kufizuese në vend, Ministria e Financave dhe Transfereve e pa të domosdoshme fillimin e shqytimit të masave edhe me fazën e dytë të adresimit të vështirësive me prejardhje nga pandemia COVID-19. Si fokus kryesor ishte zhvillimi i Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike e cila pritej të kishte ndikim dukshëm më të lartë në stabilizimin e ekonomisë në vend. Objektivat kryesore të Pakos së Rimëkëmbjes synonin që të ishin gjithëpërfshirëse sa i përket zhvillimit të ekonomisë në vend, të siguronon hapësirë financiare për të gjitha ndërmarrjet biznesore qofshin ato mikro, të vogla, të mesme apo të mëdha.

Në mënyrë që të përcaktohen masat kryesore për rimëkëmbjen ekonomike të vendit, Qeveria e Kosovës prezantoi edhe Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike COVID-19. Ky ligj u miratua në dhjetor të vitit 2020 pas disa dështimeve të njëpasnjëshme që kishte nga mungesa e votave të mjaftueshme për miratimin e tij. Qëllim kryesor i këtij ligji qëndron në plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve të përcaktuara në dispozitat e këtij ligji, e gjithë kjo me qëllim të mundësimit të rimëkëmbjes ekonomike pas atyre efekteve negative që kishtet shkaktuar pandemia COVID-19 në ekonominë e vendit. Vlera e kësaj pakoje është paraparë të jetë rreth **1.26 miliard euro** të shpërndara në sektore të caktuara.

Ky ligj përfshinë plotësimin dhe ndryshimin e këtyre ligjeve:

- Ligjin Nr. 05/L-057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore
- Ligjin Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L115, me Ligjin 04/L-168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116
- Ligjin Nr. 05/L-128 për Tatimin mbi të Ardhurat Personale
- Ligjin Nr. 05/L-037 për Tatim mbi Vlerën e Shtuar
- Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe Ligjin Nr. 05/L-007
- Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.04/L-102, Ligjin 04/L-115 dhe Ligjin Nr. 04/L-223
- Ligjin Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, Ligjin Nr. 05/L-080 dhe Ligjin Nr. 06/L-023
- Ligji Nr. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurorim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-158
- Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

Aktivitetet minerare dhe zbatimi i Ligjit të Rimëkëmbjes

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike përmbanë masa të cilat sipas saj përfshijnë sektoret më të prekur gjatë pandemisë. Si masë e kësaj pakoje është marrë edhe lirimi i subjekteve që merren me aktivitete minerare nga renta minerare që ata janë të obliguar ta paguajnë. Në bazë të Nenit 14 të Ligjit Nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike – COVID 19 “lirohen nga pagesa e rentës minerare prej datës 1 janar 2021 deri më 31 maj 2021 të gjitha subjektet që obligohen ta paguajnë këtë rentë”. Sipas këtij ligji, të gjitha subjektet të cilat kanë paguar tatjemen ose ndryshe rentën minerare, do jenë të liruar për 5 muaj ndaj këtij detyrimi. Kjo ka zgjuar debate të shumta pasi që përfitimi ndaj kësaj mase është paraparë si joracional dhe jo me ndonjë efekt signifikant në rimëkëmbje ekonomike të vendit.

E gjithë kjo vie pasi që përfituesit kryesor ndaj kësaj mase janë në total dy ndërmarrje të mëdha të cilat vlen të të përmenden:

1. **KEK**, e cila ndërmarrje duke u bazuar në inkasimin nga vitet e kaluara përfiton përafërsisht 10,500.000.00 EUR nga masat e Pakos së Rimëkëmbjes.
2. **NewCo Ferronikeli Complex L.L.C**, e cila ndërmarrje duke u bazuar në inkasimin ngavitet e kaluara përfiton përafërsisht 700,000.00 EUR nga masat e Pakos së Rimëkëmbjes.

Vlen të theksohet se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) pas miratimit të kësaj Pakoje, ka bërë plotësim/ndryshimin e këtij vendimi duke qartësuar që subjektet, në këtë rast ndërmarrjet, do të lirohen nga pagesa e rentës minerare vetëm për sasinë e planifikuar sipas Projektit të Shfrytëzimit (planifikimi vjetor), që shpërndahet në baza mujore⁵

Subvencionimi i BRE-ve dhe Ligji i Rimëkëmbjes Ekonomike

Në kuadër të këtyre masave për rimëkëmbje është edhe subvencionimi i tarifës së BRE-ve për të gjithë konsumatorët për 5 muaj për periudhën 01 janar deri më 31 maj 2021. Sa i përket kësaj mase, pjesa e energjisë elektrike që ata paguajnë për energjinë elektrike që e marrin nga prodhuesit e energjisë nga BRE-të do të subvencionohet nga Qeveria e Kosovës. Kjo pasi që Qeveria në bazë të nenit 15 të ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka ndarë shumën 8 deri në 16 milionë euro, e cila do t'u jepet prodhuesve përmes KOSTT-it. Pra, subvencionimi është i lidhur direkt me prodhuesit e BRE-ve, rrjedhimisht zbritja në euro lidhet me konsumin e energjisë elektrike, por që këtë rast konsumatorët ndihmohen nga Qeveria në formë indirekte.

Në kuadër të kësaj mase, përfitues kryesor mbesin qytetarët e Kosovës. Kjo pasi që në bazë të dhënave të marrura nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike, faturimi i energjisë elektrike për muajin janar 2021, ka qenë rreth 33mil€, për dallim prej 28mil€ sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Prej tyre me subvencionimin nga Qeveria për BRE, qytetarët e Kosovës do të paguajnë fatuarat e tyre me një zbritje prej 9%, përkatësisht rreth 2.9mil euro më pak gjatë këtijmuaji.

⁵ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. (2021). Vendim për lirim nga pagesa e rentës minerare. E qasshme në: https://kosovomin.org/wp-content/uploads/2021/01/Vendimi-01_2021-per-Lirimin-nga-Pagesa-e-Rentes-Minerare-shq.pdf (i qasur më dhjetor 2020)

Sektori financiar dhe Pakoja e Rimëkëmbjes

Ndër masat kryesore të paraqitura në Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, mbetet padyshim sigurimi i likuiditetit financiar përmes skemës garantuese të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK). Kjo masë ka një rol mjaft të rëndësishëm në rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit pasi që vetë qëllimi kryesor i saj qëndron në përkrahjen e ndërmarrjeve të ndikuara nga kriza si dhe ndërmarrjet me rëndësi strategjike për ekonominë e Republikës së Kosovës. Kjo masë ka rëndësi të madhe veçmas në rritjen e likuiditetit për ndërmarrjet mikro, të mesme dhe të vogla (NMVM-të).

Kjo masë filloi me miratimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore krijoi pesë dritare garantuese me qëllim mbështetjen e financave për NMVM-të⁶. Këto dritare do ndihmojnë bizneset kosovare në rritjen e qasjes në financa, reduktimin e kolateralit, shpejtimin e përpunimit të kërkesave për kredi si dhe do ju japin bizneseve një mundësi të dytë sa i përket ndërtimit të një qëndrueshmëri të tyre.

Rezultatet pozitive të kësaj mase janë pasqyruar që në muajt e parë (dhjetor 2020 – janar 2021). Vetëm gjatë këtyre muajve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar dallohet një rritje prej 40% të fluksit të aplikimeve për kredi. Muajt në vijim ky fluks pritet të rritet edhe më shumë duke konkluduar kështu se kjo masë është duke e dhënë kontributin e vet në rimëkëmbjen ekonomike.

Numri më i madh i aplikueve kryesisht janë ndërmarrjet mikro të cilat kanë të punësuar deri 5 punëtorë. Këto ndërmarrje përfshijnë rreth 80% të aplikimeve, për dallim prej ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat kanë përqindje më të vogël të aplikueshmërisë. Kjo përqindje parashihet të mbetet e ngjashme edhe muajt në vijim, pasi që bizneset mikro janë ato të cilat prijnë me aplikimet për kredi.

Dritaret në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE)

Dritaret në kuadër të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE)	Numri i kredive	Vlera e Kredisë	Vlera e Garancisë	Vlera mesatare e kredisë	Vlera mesatare e garancisë
Dritarja e Grave në Biznes	22	792600	626580	37027	28481
Dritarja e Bujqësisë	11	254100	168630	23100	15330
Dritarja e Prodhimit	17	746450	571210	43909	33601
Dritarja e Shërbimeve	23	832500	642800	36196	27948

⁶ Fondi Kosovar Për Garanci Kreditore, (2021), Dritaret e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. I qasshëm në: <https://fondikgk.org/vijat-garantuese/pako-e-rimekembjes-ekonomike/> (i qasur në janar 2021)

Dritarja e Tregtisë	57	4166000	2955000	73088	51842
Gjithsej PRE	130	6791650	4964220	52243	381867

Në javët dhe muajt në vijim, FKGK pritet të rrisë portfolion e vet të mbështetjes me hyrjen edhe të bankave të tjera në marrëveshje. Zgjerimi i mbështetjes nga ana e FKGK-së është ndër shtyllat kryesore të Ligjit Nr. 07/L-016 të Rimëkëmbjes Ekonomike. Efektet e kësaj mbështetje në ekonomi, pritet të shihen në muajt në vijim atëherë kur priten të lirohen miliona euro në treg dhe kur bizneset do të kenë mundësinë të realizojnë investimet e mbështetura nga kjo skemë. Deri atëherë, Ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike pritet të japë rezultate të plota në mbështetjen e një ekonomie të gjunjësuar nga pandemia COVID-19.

Zbatimi i dizpozitave të Trusti

Qeveria e Kosovës ka përfshirë edhe tërheqjen e 10 përqindëshit të kontributeve personale në mënyrë që të kjo masë të ndihmojë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit së bashku edhe me masat e tjera që përfshinë ky ligj. Në bazë të këtij Ligji, “pjesëmarrësit në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës mund të tërheqin 10% të kursimeve të tyre pensionale si shkak i krizës që është shkaktuar nga pandemia”. Aplikimi për tërheqjen e 10% të trustit ka filluar me datën 11 dhjetor 2020 dhe do vazhdojë deri më 6 prill 2021.

Mundësia që i është dhënë kontributdhënësve për tërheqjen e 10 përqindëshit të kursimeve nga Trusti pritet që do të ndihmojë në rritjen e kërkesës agregate duke rritur konsumin, sektorin e shërbimeve, dhe në disa raste edhe ndërtimtarinë. Kjo pasiqë duke rritur kërkesën agregate shteti do të përfitojë nga Tatimi në Vlerën e shtuar si përfitim direkt. Kurse, sa i përket përfitimit indirekt, vlera e tij padyshim se do të jetë shumë më e madhe pasi që do të ndikojë në ruajtjen e vendeve të punës, sektor ky i cili rrezikohet të dëmtohet shumë nëse pandemia do të vazhdojë me të njëjtin trend edhe për një kohë të pacaktuar.

Se ka filluar të ndikojë në Rimëkëmbjen Ekonomike kjo masë dhe masat e tjera të cilat u aprovuan me miratimin e Ligjit të Rimëkëmbjes Ekonomike mund ta ilustrojmë edhe përmes të dhënave që i gjejmë tek Agjencia Statistikore e Kosovës (ASK). Sipas ASK, eksporti i mallrave në muajin janar 2021 kishte vlerën 42,5 milion euro, ndërsa importi 235,8 milion euro, është një rritje prej (47.1%) për eksport si dhe (6.6%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2020.

Këto vlera më së miri dëshmojnë se menëherë pas mundësimit të tërheqjes së 10 përqindëshit nga Trusti, ku vetëm deri më datë 31 dhjetor 2020, u janë shpërguar qytetar[ve të Kosovë rreth 184 milion euro.

⁷ Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, (2021), Dritaret e Pakos së Rimëkëmbjes, e qasshme në: [PAKO E RIMËKËMBJES EKONOMIKE | Kosovo Credit Guarantee Fund \(fondikgk.org\)](https://www.fondikgk.org) (e qasur më: shkurt 2020)

Aplikimet për tërheqjen e 10% (në pesë ditët e para)

Shuma e 10% për tërheqje	Kanë aplikuar	Në %	Aplikues të mundshëm	Përqindja që kanë aplikuar
Deri €10	8,193	2.4%	99,800	8.2%
€11 deri €50	45,675	13.3%	135,211	33.8%
€51 deri €100	42,532	12.3%	80,547	52.8%
€101 deri €200	56,903	16.5%	88,495	64.3%
€201 deri €500	82,265	23.9%	109,791	74.9%
€501 deri €1000	63,021	18.3%	73,026	86.3%
€1001 deri €2000	35,495	10.3%	43,851	80.9%
€2001 deri €4000	8,580	2.5%	11,568	74.2%
Mbi €4000	1,664	0.5%	2,293	72.6%
Gjithsej	344,328	100.0%	644,582	53.4% ⁸

⁸ Trusti, (2020), Aplikimet për tërheqjen e 10%-shit në pesë ditët e para, e qasshme në: <http://www.trusti.org/sq/aplikimet-per-terheqjen-e-10-shit-ne-pese-ditet-e-para/> (e qasur më: dhjetor 2020)

Përfundime

Pakoja e Rimëkëmbjes është hartuar pa përfshirjen në diskutim të të gjitha palëve, përfshirë palëve zbatuese. Të gjitha institucionet që kemi intervistuar kanë deklaruar që nuk kanë pasur asnjë konsultë paraprake nga ana e institucioneve me rastin e hartimit të pakove të rimëkëmbjes. Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale nuk ishte konsultuar fare kur ishte liruara pagesa e rentës minerale ashtu që të njëjtit është dashur që përmes një vendimi shtesë të rregullojnë një mangësi ligjore që ka mundur të rregullohet që në fazën e zbatimit.

Dispozitat e trustit kanë gjetur më së shumti zbatim. Mbi 50% të qytetarëve me të drejtë aplikimi e kanë bërë këtë në Trustin pensional apo thënë më ndryshe mbi 340 mijë aplikues. Pjesa më e madhe e qytetarëve kanë parë tashmë mjetet e tyre të ekzekutuara në llogaritë bankare. Ndonëse nuk ka një matje sistematike nga ana e institucioneve mbi destinimet e shpenzimit të këtyre mjeteve, ne kemi vërejtur një rritje të sasisë së importit në kohën e zbatimit të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike që tregon për rritjen e fuqisë blerëse në ekonominë e Kosovës.

Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive është në përgatitje përfundimtare të dritareve të reja në kuadër të Ligjit për Rimëkëmbje. Ndonëse nga ana teknike, Fondi ka bërë të gjitha përgatitjet, një pjesë e marrëveshjeve me bankat komerciale ende nuk janë finalizuar. Me përfundimin e këtyre marrëveshjeve pritet që të fillojnë të shihen më qartë të gjitha benefitet e zbatimit të pakos së rimëkëmbjes.

Dispozitat sa i takon taksës së energjisë së ripërtrishme kanë ngecur në zbatim për shkak të vendimeve të Qeverisë për të mos financuar subvencionimin sipas kërkesave ligjore. Qeveria e Kosovës ka marrë vendimin Nr. 03/64 me datë 12 shkurt 2021 me anë të së cilit ka zvogëluar sasinë e subvencionimit të taksës së BRE-së. Për këtë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka njoftuar që pjesa e subvencionimit do të mbulohet vetëm për muajt janar, shkurt dhe mars.

Pjesa e Ligjit që ka të bëjë me lirimin nga pagesa e rentës minerare kanë gjetur zbatim të duhur, ndonëse ka pasur dilema sa i takon zbatimit të legjislacionit në fushën e ndihmës shtetërore. Duke qenë se nga rreth 13 milion euro janë para që pritet të lirohen nga pagesa e rentës minerare, 10 milion prej tyre apo rreth 80% e mjeteve do të subvencionohen për vetëm një operator KEK SH.A. Kjo ka ngritur shtetësimë tek organizata të shoqërisë civile të cilat kanë argumentuar që kjo e vë në pozicion të favorizuar njërin nga operatorët në tregun e energjisë duke vënë në lëvizje këtë Komision. Ndonëse ende nuk ka ndonjë veprim konkret, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë është vënë po ashtu në dijeni dhe janë duke e monitoruar situatën me kujdes.

Ka pasur një mungesë të komunikimit të duhur ndër-institucional për zbatimin e pakos, në veçanti në fushën e mbledhjes së statistikave. Për momentin, institucionet e Kosovës, veçanërisht institucionet e thirrura për të dhëna statistikore si Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe Banka Qëndrore e Kosovës nuk janë duke mbledhur të dhëna në baza të rregullta mbi zbatimin e Pakos së Rimëkëmbjes. Për më tepër, nuk ka një kornizë të qartë të indikatorëve që do të ishin specifik vetëm për pakon e rimëkëmbjes dhe që do të ndikonin në rritjen e informimit në baza periodike për progresin në zbatimin e Ligjit.

Rekomandime

Institucionet të sigurohen që çdo pako tjetër që miratohet në të ardhmen, të jetë paraprakisht e konsultuar me të gjitha palët e përfshira në proces. Institucionet, veçanërisht institucionet e pavarura rregullative, duhet të jenë paraprakisht të informuara mbi secilën pako e cila afekton punën e tyre. Ato duhen përfshirë në procesin e dizajnit të politikave dhe të kenë fjaën e vet në hartimin e dispozitave përfundimtare të Ligjit.

Trusti Pensional në bashkëpunim me Agjencinë e Statistikave të Kosovës të mbledhë të dhëna statistikore mbi shfrytëzimin e mjeteve të Trustit, destinimi i tyre në ekonomi dhe impakti në sektor të ndryshëm. Këto të dhëna duhet të publikohen në mënyrë periodike nën një kornizë të indikatorëve që kanë të bëjnë me zbatimin e pakove të deritanishme të rimëkëmbjes. Kjo do të rriste transparencën e zbatimit të Ligjit dhe do të informonte qytetarët mbi impaktin e secilës masë dhe do të identifikoheshin mangësitë dhe sfidat e zbatimit të secilës masë.

Fondi Kosovar për Garantimin e Kredive të përfundoj marrëveshjet me bankat komerciale dhe të përmyllë procesin e themelimit të dritareve të reja të garantimit të kredive. Përveç kësaj, Fondi, në bashkëpunim me bankat komerciale, të nisë një fushatë të vetëdijësimit dhe reklamimit të instrumenteve të reja të mbështetjes në mënyrë që të nxisë aplikimin për kredi në kuadër të skemës. Fushata e vetëdijësimit duhet të fokusohet në elementet kryesore të dritareve mbështetese, kush mund të aplikoj dhe cilat janë kushtet specifike.

Qeveria e Kosovës të siguroj fondet e nevojshme për zbatimin e dispozitave ligjore sa i takon subvencionimit të tarifës së burimeve të ripërtrishme. Nuk mundet që me Ligj të parashikohet ndryshe e me vendime qeveritare ndryshe. Zotimet buxhetore duhet të jenë në linjë me përcaktimet dhe përkushtimet e shtetit të marra me dispozita të Ligjit për Rimëkëmbjen Ekonomike.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore duhet të veproj shpejtë për të sqaruar nëse lirimi nga pagesa e rentës mireare, është në shpërputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-100 për Ndhmën Shtetërore. Nëse ka një shpërputhje të tillë, Qeveria shpejtë duhet të hartoj një plan B për mbështetjen e sektorit minerar pa favorizuar akter të veçantë të asnjë tregu.

Qeveria e Kosovës të ndërtoj një sistem të komunikimit ndër-institucional efektiv që do të shtjelloj të gjithë efektet e legjislacionit në fushën e ndihmës shtetërore dhe masat që nevojiten për të ardhmen. Ky komunikim që mund të ndërtohet përmes një mekanizmi ndër-institucional të rimëkëmbjes, duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe transparent dhe të vendosë indikator të qartë të rimëkëmbjes. Vendosja e këtyre indikatorëve do të nënkuptonte më shumë llogaridhënje nga ana e institucioneve dhe do të vendoste një njësi matëse për përcjelljen e progresit.